



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

**OSHP. nr. 1176/25
Datë: 01.09.2025**

Sekretariati i Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik duke u bazuar në nenin 98 paragrafi 2 si dhe nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 17 dhe 32 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 (e amendamentuar), pas shqyrtimit të kërkesës së AK – Komuna Mitrovica Veriore, me numër 1176/25, për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj OE. "Scorpion Security" Sh.p.k, - Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sigurimi fizik i objekteve të komunës", me nr. të prokurimit: 647-23-9599-2-2-1, më: 01.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

- Refuzohet kërkesa e AK-së (Komuna Mitrovica Veriore) për diskualifikimin e OE. "Scorpion Security" Sh.p.k, me nr. unik 810680092 nga Ferizaj, për aktivitetin "Sigurimi fizik të objekteve të komunës" me nr. prokurimit: 647-23-9599-2-2-1.
- Arsyeja e refuzimit është se kërkesa nuk është e bazuar në dispozitat ligjore të nenit 99, paragrafi 2 të LPP-së.
- Megjithatë, AK ka të drejtë ligjore që, sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), të kërkojë realizimin e të drejtave të veta përmes Gjykatës kompetente.

ARSYETIM

Kërkesa e AK - Komuna Mitrovica Veriore

1. Autoriteti kontraktues përmes kërkesës se datës 21.08.2025, ka kërkuar marrjen e masave sipas nenit 99.2 të LPP-se, ndaj OE."Scorpion Security" Sh.p.k, me arsyetimin se me operatorin ekonomik kemi nënshkruar kontrate për aktivitetin e lartpërmendur dhe i njëjti në vazhdimësi nuk i është përgjigjur kërkesave të AK-se, për përmirësimin e shërbimeve dhe përfundimin e shërbimeve sipas kontratës.
2. Në kërkesën e datës: 21.08.2025, AK – Komuna Mitrovica Veriore, ka sqaruar dhe njeherit ka bashkangjitur disa email-a, ku ka kërkuar nga operatori ekonomik kryerjen e shërbimeve sipas kontratës dhe në vazhdim të kërkesës, AK-ja ka sqaruar se pas disa kërkesave për kryerjen e shërbimeve e kemi shkëputur kontratën me OE."Scorpion Security" Sh.p.k, me rekomandimin e menaxhereve të kontratës.

Pra, autoriteti kontraktues - Komuna Mitrovica Veriore, kërkon marrjen e masave sipas nenit 99.2 të LPP-se, me arsyetimin se OE."Scorpion Security" Sh.p.k - Ferizaj, nuk e ka përmbushur kontratën sipas kushteve të parapara.

Kërkesa e OSHP-se drejtuar Operatorit Ekonomik:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me të pranuar kërkesën e datës: 21.08.2025, të AK - Komuna Mitrovica Veriore, e ka njoftuar OE". "Scorpion Security" Sh.p.k - Ferizaj, me qëllim që operatori ekonomik në fjale të jap faktet dhe argumentet e veta lidhur me kërkesën e AK-se.

OE."Scorpion Security"Sh.p.k - Ferizaj, në përgjigje të kërkesës së OSHP-se, ka kërkuar që kërkesa e AK – Komuna Mitrovica Veriore të refuzohet si e pa bazuar dhe njeherit ka dhënë faktet dhe argumentet e veta lidhur me kërkesën e AK-se. Në sqarimin e tij OE". "Scorpion Security" Sh.p.k ka sqaruar se nuk janë përmbush asnjë nga kushtet e parapara në nenin 99.2 të LPP-se, për marrjen e masave sipas dispozitave të këtij neni.

Shqyrtimi i kërkesës dhe vlerësimi i pretendimeve të Autoritetit Kontraktues për marrjen e masave ndaj OE. "Scorpion Security" Sh.p.k - Ferizaj:

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues, Kryesuesi i Sekretariatit, konstaton se autoriteti kontraktues – Komuna Mitrovica Veriore, nuk ka dorëzuar asnjë provë që dëshmon se OE. "Scorpion Security" Sh.p.k - Ferizaj, në këtë aktivitet të prokurimit, ka mashtruar apo ka falsifikuar ndonjë dokument apo dëshmi, për të cilën edhe OSHP, mund të merr masa konkrete ndaj operatorit ekonomik.

Bazuar në nenin 99.2 të LPP-së, Organi Shqyrtues i Prokurimit është i obliguar që të merr masa ndaj operatorëve ekonomik vetëm nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç potencohet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 të këtij neni, ku thuhet: *"Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare"*, e që në rastin konkret AK-ja, nuk ka arritur të ofroj ndonjë dëshmi apo prove për paraqitje të dokumenteve të rreme apo të falsifikuara nga ana e OE Scorpion Security Sh.p.k - Ferizaj, për aktivitetin e prokurimit: "Sigurimi fizik i objekteve të komunës", me nr. të prokurimit: 647-23-9599-2-2-1.

Prandaj, OSHP konstaton se në rastin konkret palët kontraktuale në kontratën e lidhur me datën: 16.11.2023, nuk kanë arritur të zgjedhin në mënyrë miqësore mosmarrëveshjet që kanë pasur dhe se sipas kushteve të veçanta të kontratës, palët mund të referohen Gjykatës kompetente, kusht ky i vendosur nga vet palët kontraktuale, të kushtet e veçanta të kontratës, konkretisht neni 21.1 *"Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën kompetente në pajtim me ligjin në Kosovës"*. Prandaj, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me mashtrim apo falsifikim sipas dispozitave të nenit 99.2 të LPP-se.

OSHP, vlerëson se Autoriteti Kontraktues të drejtën e tij kontraktuale mund të realizojë sipas Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) pranë Gjykatës kompetente.

Duke u mbështetur në nenin 99.2 të LPP-së si dhe në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,
por pala e pakënaqur me padi mund t'i
drejtohet Gjykatës kompetente për anulim vendimi ne
afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna Mitrovica Veriore

1x1 OE - Scorpion Security - Ferizaj

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

